



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2024/0606**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Kimete Gashi Brajshori Kryetare duke vendosur sipas ankesës së (OE) N.T.SH. “VETERINA” - PEJË, kundër vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të “KOMUNA E PEJËS” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Trajtimi i qeneve endacak dhe menaxhimi i strehimores ne Komunën e Pejës RITENDER” me numër të prokurimit 635-24-4874-2-1-1, me 06/09/2024, mori:

## Vendim

**1. Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE N.T.SH. “VETERINA” - PEJË me nr. 2024/0606, e datës 08/07/2024, kurse vendimi i AK ‘KOMUNA E PEJES’ lidhur me aktivitetin e prokurimit “Trajtimi i qeneve endacak dhe menaxhimi i strehimores ne Komunën e Pejës RITENDER” me numër të prokurimit 635-24-4874-2-1-1.

**2. Anulohet** njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Trajtimi i qeneve endacak dhe menaxhimi i strehimores ne Komunën e Pejës RITENDER” me nr. të prokurimit: 635-24-4874-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA E PEJES” dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

**3.** Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

**4.** Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## Arsyetim

### *- Faktet dhe rrethanat procedurale --*

Me 17.05.2024, 'KOMUNA E PEJES' në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Trajtimi i qeneve endacak dhe menaxhimi i strehimores ne Komunën e Pejës RITENDER" me nr. të prokurimit: 635-24-4874-2-1-1. Ndërsa me datën 19.06.2024 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues me të cilin ka shpërblyer me kontratë GOE KUQI FARMS SH.P.K. dhe VETERINARIA DRENAS

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të **hapur**, lloji i kontratës: - **Punë**, vlera e parashikuar e kontratës: **270.000,00 euro**

Me 21.06.2024, OE N.T.SH. "VETERINA" - PEJË ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 26.06.2024, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim si të pa bazuar.

Me 08/07/2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE N.T.SH. "VETERINA" - PEJË me nr. 2024/0606 për lidhur me aktivitetin "Trajtimi i qeneve endacak dhe menaxhimi i strehimores ne Komunën e Pejës RITENDER" me nr. të prokurimit: 635-24-4874-2-1-1.

### *-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-*

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues N.T.SH. "VETERINA" - PEJË janë parashtruar si në vijim: Përmes kësaj anekese, ne si Grup i Operatorëve Ekonomik (GOE) i përbërë nga anëtarët: OE N.T.SH. VETERINA PEJË (TURHAN NILA B.I.) dhe OE HAKI BYTYÇI B.I., e kundërshtojmë vendimin e AK për shpërblyer me kontratë të GOE KUQI FARMS SH.P.K. dhe VETERINARIA DRENAS, në lidhje me aktivitetin e prokurimit: "Trajtimi i qeneve endacakë dhe menaxhimi i strehimores në Komunën e Pejës RITENDER", me numër prokurimi 635-24-4874-2-1-1. AK përmes këtij vendimi ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë (më tej LPP) andaj në vijim po paraqesim pretendimet të cilat mbështesin ankesën tonë.

**Pretendimi 1** (LPP/Neni 1: Qëllimi): Pretendimet tona ankimore në lidhje me procesin e prokurimit të kryer nga AK janë në kundërshtim me Nenin 1 të LPP, i cili përcakton qartë nevojën për një proces transparent, të drejtë dhe efikas në përdorimin e fondeve publike. Ligji

thekson se të gjitha procedurat dhe kushtet duhet të zbatohen në mënyrë të përpiktë për të siguruar një konkurrencë të ndershme dhe të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit. Në rastin konkret, AK, duket të ketë shkelur këto parime nëpërmjet pranimit të dokumentacionit jo të plotë dhe jo të saktë nga ofertuesit, siç dëshkohet nga mungesa e dokumenteve të nevojshme dhe mungesa e iniciativës së AK për të verifikuar përmbushjen e kushteve të specifikuar në dosjet e tenderit dhe mungesa e përvojës së kërkuar tek stafi profesional dhe teknik. Në bazë të nenit 1 të LPP, janë identifikuar disa parregullsi në procesin e tenderimit të OE KUQI FARMS SH.P.K. dhe OE VETERINARIA DRENAS, të cilat bien në kundërshtim me qëllimin dhe principet e këtij ligji. Sipas dokumentacionit të paraqitur: "1.1. *Kërkesat për Përshtatshmërinë Profesionale*: OE Veterinaria Drenas nuk ka paraqitur faqen e parë të informatave të biznesit. 1.2. *Kërkesat për Mundësitë Teknike dhe Profesionale*: OE Kuqi Farms nuk ka paraqitur dëshmitë e diplomave dhe CV-të e teknikëve të veterinarisë. OE Veterinaria Drenas ka paraqitur kontratat dhe diplomat e dy teknikëve të veterinarisë, por mungojnë CV-të si dhe mungon diploma e veterinarit dhe CV. Në dosjen e tenderit mungojnë dëshmitë (fatura) për mjetet e punës: kafaz transportues, mjete kimike, qantë ushqimi, rrypa. Mungojnë mjete kimike profesionale për trajtimin e kafshëve agresive. 1.3. *Verifikimi i Objektivit të Strehimores*: Në ofertën e dorëzuar nga GOE i rekomanduar për kontratë është paraqitur vetëm fotoja e kafazeve, pa dëshmi bindëse për ekzistencën e objektit të strehimores. Për më shumë, sipas një verifikimi në terren konstatohet se objekti i strehimores dhe kafazeve nuk ekziston në ngastrën e deklaruar. 1.4. *Mungesa e Dokumentacionit për Grupin e Operatorëve Ekonomik*: Mungojnë deklaratat e anëtarëve të grupit për përgjegjësinë dhe pjesëmarrjen e tyre. Grupi i OE Kuqi Farms dhe Veterinaria Drenas nuk ka paraqitur deklaratat e qarta të kërkuara në njoftimin për kontratë. Këto veprime shkelin drejtpërdrejt kërkesën për transparencë dhe saktësi në dokumentacionin e prokurimit, duke lënë hapësirë për dyshime rreth ndershmërisë dhe objektivitetit të procesit të vlerësimit të tenderëve. Këto praktika jo vetëm që janë në kundërshtim me parimet themelore të LPP, por gjithashtu krijojnë një avantazh të padrejtë për disa operatorë ekonomikë në kurriz të të tjerëve, duke dëmtuar kështu integritetin dhe efikasitetin e tërë sistemit të prokurimit publik. Për të adresuar këto çështje, është thelbësore që OSHP të ndërhyjë për të rishikuar dhe vlerësuar shkeljet e evidentuara në këtë aktivitet të prokurimit, duke siguruar që çdo vendim të merret në përputhje me rregullativën për prokurim publik në Kosovë (Ligjin, Rregulloren dhe Udhëzuesin), për të rikthyer besimin në procesin e prokurimit dhe për të garantuar përdorimin e drejtë dhe të efikasitetit të fondeve publike."

**Pretendimi 2** (LPP/Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi): "Vendimi për diskualifikim nga AK me arsyetimin e mungesës së përgjegjshmërisë, me datë 19.06.2024 dhe vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim nga ana jonë drejtuar AK, i datës 26.06.2024, tregon trajtim të pabarabartë dhe diskriminues ndaj GOE N.T.SH. VETERINA - PEJE; HAKI BYTYÇI B.I., duke shpërfaqë tejkalim të autorizimeve të zyrtarëve përgjegjës. Më datë 19.06.2024 është publikuar B58 Njoftimi i vendimit të AK, ku Komuna e Pejës shpërblen me kontratë GOE KUQI FARMS SH.P.K. dhe AMBULANCA VETERINERE DRENAS, në vlerë totale të ofertës 241,320.00 €, dhe Letër standarde për të eliminuarin drejtuar GOE N.T.SH. VETERINA - PEJE; HAKI BYTYÇI B.I., me arsyetimin se ne jemi diskualifikuar nga komisioni vlerësues duke u mbështetur në "vendimin" e AK të datës 12.04.2024, i cili na njofton që jemi si OE i papërgjegjshëm, në mbështetje të nenit 25.9 të Rregullores Nr.001/2022 për prokurimin publik dhe Neni 99.2 të LPP. Në fakt kjo që AK i referohet "vendim" është thjeshtë kërkesë (dokumenti bashkangjitur) nga AK të cilën e njëjtë ja parashtron OSHP-së për diskualifikimin tonë përgjatë aktivitetit paraprak të prokurimit, me numër prokurimi: 635-24-2098-2-1-1. Neni 25.9 i rregullores në të cilën bazohet kërkesa e AK, thotë si në vijim: "Vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë (përveç Deklaratës nën Betim) do të kërkohen të dorëzohen nga një

tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shpërblej me kontratë. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para publikimit të Njoftimit B58 mbi vendimin e AK-së. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është jo më shumë se pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të autoritetit kontraktues për synimin e dhënies së kontratës. Dështimin dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdoj me tenderuesin e listuar në vendin e dytë, si dhe do të konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar dhe AK do të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se.” Ky nen i Rregullores flet për vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë që kërkojnë të dorëzohen nga tenderuesi para Njoftimit B58 mbi vendimin e AK-së, afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit gjegjë, konfiskimin e sigurimit të tenderit dhe iniciimin e procedurës për diskualifikim sipas Nenit 99.2 të LPP-së. Pra, bazuar në këtë nen të rregullores, AK ka kërkuar diskualifikimin, përkatësisht futjen tonë në listë të zezë, përgjatë aktivitetit të prokurimit paraprak në lidhje me tenderin në fjalë. Neni 99.2 i LPP-së përcakton rastet kur mund të paraqitet kërkesa e tillë si dhe përcakton autoritetin e OSHP-së si autoritet kompetent për të vendosur në bazë të kërkesës së AK. Në rastin tonë konkret, AK pa asnjë provë të paraqitjes së të dhënave të rreme ose dokumentacionit të falsifikuar dhe pa asnjë vendim të OSHP në këtë drejtim, tregon një zbatim të padrejtë të nenit 99.2 të LPP dhe shkelje të nenit 7 për barazi në trajtim dhe jo-diskriminim. Gjatë aktivitetit të fundit të prokurimit, ne jemi të vetmit kandidatë të cilët plotësojmë kushtet në tërësi, sipas kërkesave të listuara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Megjithatë, aplikimi jonë as nuk është shqyrtuar dhe AK na njofton se jemi diskualifikuar nga komisioni vlerësues, me ç ‘rast AK ju ka referuar kërkesës për diskualifikimin tonë të cilën e njëjta ja ka drejtuar OSHP-së me datë 12.04.2024, duke e konsideruar këtë kërkesë si vendim i marrë në bazë të së cilës ne po trajtohem si OE i papërgjegjshëm dhe aplikimi jonë refuzohet në tërësi, edhe pse akoma nuk kemi asnjë vendim nga OSHP në këtë drejtim. Në këtë pikë, ne kemi shfrytëzuar të drejtën tonë ligjore për ankesë dhe brenda afatit ligjor dhe kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim pranë AK (dokumenti bashkangjitur). Më datë 26.06.2024, AK ka ngarkuar përgjigje në kërkesën për rishqyrtim me ç ‘rast jemi njoftuar si në vijim: “A.K pas analizës së kërkesës së juaj për Ri-shqyrtim duke marr për baze kërkesën tuaj në platformën elektronike të datës: 20.06.2024,e ka trajtuar me kujdes kërkesën tuaj, dhe ka ardhur në përfundim se e njëjta është e pa bazuar., Pasi qe nga AK Komuna e Pejës me datën 12.04.2024 ka bere kërkesë për konfiskim të sigurimit të ofertës si dhe kërkesën për futjen në listën e zezë të OE N.T.SH. VETERINA - PEJE; Haki Bytyçi B.I “Për arsyeje qe ju jeni në kundërshtim me LPP-ne andaj ne si AK ju njoftojmë se ankesa juaj nuk merret për baze, pasi qe ju jeni si OE i pa përgjegjshëm duke u mbështetur ne vendimin e datës 12.04.2024.” Siç shihet më lartë, edhe njëherë AK ju ka referuar kërkesës që ka bërë drejtuar OSHP-së për diskualifikimin tonë, me datë 12.04.2024, duke e konsideruar të njëjtën si “vendim” i marrë në bazë të së cilës ne po trajtohem si OE i papërgjegjshëm, edhe pse akoma nuk kemi asnjë vendim nga OSHP në këtë drejtim. Ky zbatim jo i duhur, jo vetëm që dëmton reputacionin dhe mundësitë e biznesit tonë por edhe minon besimin në procesin e prokurimit publik si të ndershëm dhe të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit. Për me shumë, përgjegjësi/it e prokurimit tejkalojnë autorizimet duke marrë vendime të pabazuara në Ligj dhe në të njëjtën kohë marrin përgjegjësi që sipas LPP i takojnë Organit Shqyrtues të Prokurimit. Për të adresuar këto çështje efektivisht, është e rëndësishme që të sigurojmë që të gjitha palët të kenë mundësi të barabarta për të konkurruar dhe të mbrojtur të drejtat e tyre sipas ligjit. Ndërhyrja e OSHP dhe rishikimi i procesit të prokurimit janë hapat kyç për të garantuar një konkurrencë të ndershme dhe të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë të përfshirë.”

***Pretendimi 3*** (LPP/Neni 59: Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve):*3.1. Mungesa e Objektivitetit në Vlerësimin e Ofertave:* AK ka bërë tolerime ndaj një numri të konsiderueshëm të

gabimeve gjatë procesit të ekzaminimit dhe vlerësimit të dosjes së GOE KUQI FARMS SH.P.K. dhe AMBULANCA VETERINERE DRENAS. Sa i përket kërkesave të përshtatshmërisë profesionale (7.1 & 7.2), kërkesa 1, në dokumentacionin e OE VETERINARIA DRENAS, mungon faqja e parë e informatave të biznesit. Konform kushteve specifike për kontratat e shërbimeve – krijimi i grupit të operatorëve ekonomik (11.1), mungojnë të gjitha deklaratat e listuar më poshtë, duke përfshirë: a) një deklaratë të qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit, në rast se grupit i ipet kontrata për ekzekutimin e kontratës; b) Një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarë, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë në mënyrë individuale apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtë të prokurimit; c) Një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit. ? Grupi i OE KUQI FARMS SH.P.K dhe OE VETERINARIA DRENAS, kanë paraqitë një marrëveshje konzorciumi për kryerjen e shërbimeve veterinarë në terren, ku palët janë dakorduar se udhëheqës i grupit të jetë OE KUQI FARMS SH.P.K, me drejtor Betim Kuqin, dhe të njëjtit nuk kanë paraqitur deklarata të qarta sic është kërkuar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. AK ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve dhe si përfundim ka marrë vendim që të shpallë fitues OE KUQI FARMS SH.P.K. dhe OE VETERINARIA DRENAS, megjithëse të njëjtit kanë gjithë këto mangësi të dokumenteve të kërkuara në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit. AK, përveç mungesës së dokumenteve të listuara më sipër, ka injoruar në tërësi kërkesën tonë për verifikim të ekzistencës së objektit të strehimores dhe kafazeve, të paraqitura nga OE KUQI FARMS SH.P.K. në ngastrën me numër kadastral 00559-5 në ZK Lutogllavë Pejë dhe e ka trajtuar kërkesën tonë si të pabazuar sic është shpjeguar në pretendimin nr.2 të kësaj ankese. Vlen të përmendet se kjo është hera e parë që AK po punon drejt realizimit të një projekti për trajtimin e qeneve endacakë dhe të njëjtit nuk janë të vetëdijshëm për përgjegjësinë, vështirësitë dhe rreziqet me të cilat shoqërohet implementimi i një projekti të natyrës së tillë. Për këtë arsye, është jashtëzakonisht e rëndësishme që kriteret të cilat janë përcaktuar nga AK të respektohen në tërësi dhe punët për kryerjen e një projekti të tillë të realizohen nga një operator i përgjegjshëm me përvojë të suksesshme në kryerjen e projekteve të ngjashme, për çka ne edhe kemi ofruar referencë nga AUV për përfundimin e suksesshëm të projekteve të ngjashme për trajtimin e qeneve endacakë në Komunën e Pejës, projekt ky i financuar nga AUV. Në dosjen tonë të tenderit kemi bashkëngjite licencën e lëshuar nga AUV e cila dëshmon se strehimorja jonë i plotëson të gjitha kushtet teknike për realizimin e tenderit në fjalë. Sipas pretendimeve të listuara më sipër, shihet se AK ka shpallur fitues kompaninë GOE KUQI FARMS SH.P.K dhe AMBULANCA VETERINERE DRENAS pa një proces të qartë dhe të drejtë vlerësimi që përputhet me të gjitha kërkesat e specifikuar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Ky veprim nënçmon rëndësinë e një vlerësimi të drejtë dhe të barabartë të të gjitha ofertave, duke favorizuar disa operatorë ekonomikë në kundërshtim me kërkesat e qarta të ligjit."

***Pretendimi 4*** (LPP/Neni 69: Aftësitë teknike dhe profesionale): Neni 69 i LPP përcakton kërkesat për aftësitë teknike dhe profesionale që operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë për të kualifikuar për kontrata publike. Ky nen synon të sigurojë që të gjithë ofertuesit të kenë kapacitetin e nevojshëm për të përmbushur kërkesat e kontratës. Duke u bazuar në pretendimet e ofruara më poshtë, duket se ka disa shkelje specifike të këtij neni në lidhje me procesin e prokurimit nga AK: *4.1. Mungesa e Dëshmimeve për Kualifikimet Profesionale: Në mbështetje të kërkesave mbi mundësitë teknike dhe profesionale 9.1 & 9.2, Kërkesa 1 në FDT: OE duhet të ofroj dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon: - Një (1) veterinar të diplomuar, min 2 vite përvojë pune pas diplomimit në fushën e trajtimit të kafshëve; dhe - Dy (2) teknikë të veterinarisë, min 2 vite përvojë pune pas diplomimit. Dëshmia 1 Si dëshmi duhet dorëzuar: -*

kontratën për marrëdhënie pune; - kopjet e diplomave; dhe - CV e tyre me më së paku 2 vite përvojë pune. OE KUQI FARMS SH.P.K i ka paraqitur dy kontrata me teknikë të Veterinarisë: Auron Gashi dhe Endrit Demaj. Mungojnë dëshmia e diplomave dhe CV-të e të dy teknikëve të lartcekur, ku dëshmohet përvoja e punës, minimum dy vite përvojë pune pas diplomimit. Te OE VETERINARIA DRENAS, mungon dëshmia për stafin profesional – diploma e veterinarit dhe CV ku dëshmohe minimum dy vite përvojë pune pas diplomimit. OE VETERINARIA DRENAS i ka paraqitë kontratat dhe diplomat e dy teknikëve të veterinarisë: Daut Millaku dhe Kreshnik Zogaj. Mungojnë CV-të e të dy teknikëve të lartcekur, ku dëshmohet përvoja e punës, minimum dy vite përvojë pune pas diplomimit. OE KUQI FARMS SH.P.K. dhe OE Veterinaria Drenas nuk kanë paraqitur dokumentacion të plotë për kualifikimet e stafit të tyre teknik dhe profesional. Ky veprim bien në kundërshtim me nenin 69, i cili kërkon që të gjitha dokumentet që vërtetojnë aftësitë dhe kualifikimet e ofertuesve të jenë të plota dhe të verifikueshme.

**4.2. Mungesa e Dëshmive për Mjetet e Punës:** Në lidhje me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale 9.1 & 9.2, Kërkesa 3: Lista e mjeteve të punës në dispozicion për realizimin e punimeve. - Pikap - Minimum 1 copë - Kafaz transportues - Minimum 1 copë - Qafore, qante ushqimi dhe mjete kimike që mund të përdoren për kafshë agresive - Minimum nga një 1 copë Dëshmia 3: Lista e mjeteve duhet të dorëzohet e skanuar nga origjinali - e nënshkruar dhe vulosur nga O.E. Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohe me librezën e regjistrimit, ndërsa pajisjet tjera, OE duhet t'i dëshmojë me një dokument për pronësinë e tyre (faturë, DUD etj.). Vëmendje! Në rast se OE nuk posedon ndonjë nga pajisjet e kërkuara, duhet të ofrojë marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët. Pajisjet motorike duhet të jenë të regjistruara dhe të kenë sigurim valid. Vërejtje: Autoriteti Kontraktues mban të drejtën që të bëjë verifikimin e pajisjeve të ofruara. Në rast të mospërputhjes së të dhënave, OE do të eliminohet. Në dosjen e tenderit të mjetet e punës të paraqitura nga OE KUQI FARMS SH.P.K dhe OE VETERINARIA DRENAS, mungon dëshmia (fatura) për mjetet në vijim: kafaz transportues, mjete kimike, qantë ushqimi, rrypa. Te mjetet e punës mungojnë mjete kimike profesionale për trajtimin e kafshëve agresive. Në dosjen zyrtare janë paraqitur vetëm pajisjet për mjete kimike por jo mjetet kimike adekuate. Kjo mungesë dokumentacioni që vërteton disponueshmërinë e mjeteve të nevojshme për kryerjen e shërbimeve sugjeron një mos përmbushje të standardeve të kërkuara, duke rrezikuar cilësinë e shërbimeve të ofruara.

**4.3. Verifikimi i Objektivit të Strehimores:** Sa i përket kërkesave mbi mundësitë teknike dhe profesionale 9.1 & 9.2, Kërkesa 4: OE duhet të prezantojë objektin (tipin) e strehimores së qenve dhe ambulancën e specializuar për këto shërbime, të cilat duhet të jenë brenda territorit të Komunës së Pejës, minimum 15 km. Dëshmia 4: OE duhet të ketë në pronësi të vet objektin (tipin) e strehimores së qenve dhe ambulancën brenda territorit të Pejës, minimum 15 km, të dëshmuar me foto ose fletë posedimi. Në rast se OE nuk posedon objektin (tipin) e strehimores së qenve të kërkuar, duhet të ofrojë marrëveshjen për marrjen me qira të objektit. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate, e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët. Marrëveshja duhet të jetë e noterizuar – e nënshkruar ndërmjet qiradhënësit dhe qiramarrësit në prani të noterit. Në dosje është paraqitur vetëm fotoja e kafazeve, e cila nuk është aspak bindëse, ndërsa askund nuk shihet objekti i strehimores. Në kemi bërë një verifikim në ngastrën me numër kadastral 00559-5 në ZK Lutogllavë Pejë, ku rezulton se nuk ka asnjë objekt të strehimores apo kafazë siç është paraqitur në dosjen e tenderit. Në ngastrën fqinje është një objekt i cili shfrytëzohet si fabrikë e qumështit dhe siç duket OE KUQI FARMS SH.P.K po i referohet të njëjtës për objekt të strehimores. Në kërkesën tonë për rishqyrtim drejtuar AK, ne kemi kërkuar të bëhet verifikimi i vërtetësisë (inspektim) për ekzistencën e objektit të strehimores së OE KUQI FARMS SH.P.K, siç parashihet me nenin 69.3

të LPP, por kërkesa jonë është refuzuar si e pabazuar. Kërkojmë nga OSHP verifikim të vërtetësisë së objektit të strehimores dhe kafazeve, të cilët OE KUQI FARMS SH.P.K pretendon t'i ketë në shfrytëzim sipas kontratës së noterizuar me numër rendor 7156/2024, si pjesë e ngastrës me numër kadastral 00559-5 në ZK Lutogllavë Pejë. Ju lutem të verifikohet saktësisht ngastra me numrin e lartcekur nëse posedon kafazë dhe objekt të strehimores të përshtatshëm për trajtimin e qenëve endacakë. Objekti i strehimores i cili dyshojmë të jetë ekzistues, duhet të ketë sallën e operimit si dhe ambiente të përshtatshme dhe profesionale për kryerjen e shërbimeve veterinare, në përputhje me standardet për strehimore sipas UA nr. 04/2017. (shih UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR) - NR.04/2017 PËR KUSHTET TEKNIKE TË CILAT DUHET PLOTËSUAR QENDRAT E TRAJTIMIT TË PËRKOHSHËM TË KAFSHËVE ENDACAKE). Siç shihet më lartë, AK bien në kundërshtim me kërkesat e nenit 69 të LPP, duke cenuar integritetin dhe efikasitetin e tërë procesit të prokurimit publik. Këto shkelje mund të ndikojnë jo vetëm në cilësinë e shërbimeve të ofruara nga kontraktorët, por gjithashtu mund të komprometojnë parimet e barazisë, transparencës dhe konkurrencës së ndershme në prokurimin publik. Këto çështje kërkojnë vëmendje të menjëhershme dhe ndërhyrje nga OSHP për të adresuar dhe korrigjuar çdo mospërputhje me ligjin.

**Pretendimi 5** (LPP/Neni 99: Funkcionet dhe Kompetencat e OSH): "OSHP duhet ta vlerësoj drejtë faktin se a ka pasur të drejtë AK të përjashtojë GOE N.T.SH. VETERINA - PEJE; Haki Bytyçi B.I. duke e shpallë si të papërgjegjëm, duke u mbështetur në "vendimin" e datës 12.04.2024, e cila në fakt është thjeshtë kërkesë nga AK drejtuar OSHP për diskualifikimin e GOE N.T.SH. VETERINA - PEJE; Haki Bytyçi B.I. Në rastin tonë konkret, ne nuk kemi paraqitur as të dhëna të rrejshme që do të mund të shkaktonin lajthim për AK e aq më pak ndonjë dokument të falsifikuar. Ne thjeshtë e kemi dërguar deklaratën tonë tek AK duke e theksuar arsyen e tërheqjes nga tenderi (RITENDERI) i AK me numër të prokurimit 635-24-2098-2-1-1. Tërheqja është bërë për shkak të mospranimit të punëtorëve të angazhohen në bazë të pagesës së paraparë në çmimorën e dorëzuar tek AK. Tre (3) nga katër (4) teknikët e propozuar të veterinarisë, kanë dhënë edhe deklaratë me shkrim për këtë tërheqje për shkak të çmimit të ulët, vështirësive dhe rreziqeve që ju kanosen gjatë punës, dukë përfshirë edhe kafshimet potenciale nga qentë endacakë, pleshtat dhe sëmundjet e tjera bartëse, si dhe agresivitetin që këta qenë e kanë. Për arsyet e sipërpërmendura, teknikët e veterinarisë kane refuzuar ta ndërmarrin këtë përgjegjësi me shumën me të cilën kemi aplikuar në aktivitetin paraprak të tenderimit. Po të aplikohet drejtë e drejta materiale nga neni 99 paragrafi 2 i LPP-së, atëherë arrihet tek përfundimi se autoriteti i vetëm për të shqyrtuar dhe diskualifikuar një operator ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik është OSHP, dhe në asnjë mënyrë ligji nuk i'a ka njohur këtë të drejtë AK-së. Neni 99 paragrafi 2 i LPP-së përcakton: "Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare." Neni 99 paragrafi 1 i LPP-së përcakton: "OSHP është përgjegjëse për zbatimin e procedurave për shqyrtimin e prokurimit sipas Pjesës IX të këtij ligji dhe kanë autoritetin dhe përgjegjësitë e parashikuara në atë Pjesë." Nga leximi i kësaj dispozite, vërtetohet fakti se OSHP është përgjegjëse për zbatimin e procedurave për shqyrtim të prokurimit dhe si rrjedhojë edhe ka autoritetin dhe përgjegjësitë të cilat i mveshen. AK ka vepruar gabimisht kur ka konsideruar se GOE N.T.SH. VETERINA - PEJE; Haki Bytyçi B.I është OE i papërgjegjshëm, pasi që veprimet tona nuk mund të konsiderohen si paraqitje e të dhënave të rreme ose si paraqitje e një dokumenti të falsifikuar, mirëpo edhe po të ishin veprime që hyjnë në kuadër të nenit 99 të LPP-së, nuk ka ndonjë vendim të OSHP me të cilin do të diskualifikoheshim nga pjesëmarrja në aktivitete të prokurimit publik. Shtuar kësaj, Gjykata

Komerciale e Republikës së Kosovës, si organ i vlerësimit të ligjshmërisë së veprimeve të organeve administrative, të cilat janë përfundimtare, tashmë ka vendosur në dy raste të ngjashme dhe në të dy rastet, e drejta i është dhënë palës paditëse e cila ka sfiduar veprimet e organeve. Nga vendosja e gjykatës, vërtetohet fakti se veprimet e tilla janë të kundërligjshme. (I referohemi vendimeve KA.nr. 206/23 dhe KA.nr.215/23).

Të nderuar Anëtarë të Panelit Shqyrtues, I/E nderuar Ekspert Shqyrtues, Bazuar në faktet e theksuara më sipër, në këtë aktivitet të prokurimit, AK ka rekomanduar për shpërblim me kontratë grupin e OE KUQI FARMS SH.P.K. dhe OE VETERINARIA DRENAS, megjithëse shihet qartë se të njëjtit nuk i plotësojnë kërkesat e dosjes së tenderit për aktivitetin në fjalë. Andaj, kërkojmë nga OSHP që lëndën ta kthejë në rishqyrtim dhe të obligohet AK që ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve ta bëjë në përputhje me dispozitat e LPP-së.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër N.T.SH. "VETERINA" - PEJË konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59, 69 dhe 99 të LPP-së. Duke marrë në konsideratë të gjitha provat dhe argumentet e prezantuara më lartë, me respekt i kërkojmë Organit Shqyrtues të Prokurimit që pas kësaj ankese të nxjerrë këtë: VENDIM që të APROVOHET në tërësi si e bazuar ankesa e GOE N.T.SH. VETERINA PEJË (TURHAN NILA B.I.) dhe HAKI BYTYÇI B.I. dhe të ANULOHET Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 26.06.2024 dhe lënda kthehet në RIVLERËSIM. DETYROHET Autoriteti Kontraktues që në afat prej 10 ditësh, ta informoj OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP. LEJOHET të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës."

***Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim:*** "Operatori Ekonomik N.T.SH. VETERINA- PEJË me datën 20.06.2024, ka parashtruar kërkesën për Ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Prok: Trajtimi i qeneve endacak dhe menaxhimi i strehimores ne Komunën e Pejës RITENDER me Nr. të Prok: 635-24-4874-2-1-1 nr i 635-24-073-211 nxjerr: Autoriteti Kontraktues , me datën 26.06.2024 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë: A.K pas analizës se kërkesës se juaj për Ri-shqyrtim duke marr për bazë kërkesën tuaj në platformën elektronike të datës: 20.06.2024,e ka trajtuar me kujdes kërkesën tuaj, dhe ka ardhur ne përfundim se njëjta është e pa bazuar., Pasi qe nga AK Komuna e Pejës me datën 12.04.2024 ka bere kërkesë për konfiskim te sigurimit te ofertës si dhe kërkesën për futjen ne listën e zezë te OE N.T.SH. VETERINA - PEJË; Haki Bytyçi B. Për arsyeje qe ju jeni ne kundërshtim me LPP-ne andaj ne si AK ju njoftojmë se ankesa juaj nuk merret për baze, pasi qe ju jeni si OE i pa përgjegjshëm duke u mbështetur ne vendimin e datës 12.04.2024."

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 19.07.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0606/2024, ndërsa me datë 30.07.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0606 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.



Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtuese, ndërsa OE pajtohet me raportin e ekspertes shqyrtuese.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

#### **- Administrimi dhe vlerësimi i provave –**

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertes, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE N.T.SH. “VETERINA” - PEJË - ekspertja shqyrtuese përmes raportit nr. 2024/0606 ka vlerësuar si në vijim:

**Konstatimi i parë (I)** - Lidhur me pretendimin e I , ekspertja shqyrtuese ne baze te pretendimit ankimor sqaron se pretendimi ankimore lidhur me Kërkesat për Përshtatshmërinë Profesionale se OE Veterinaria Drenas nuk ka paraqitur faqen e parë të informatave të biznesit. *Kërkesa e Autoriteti Kontraktues sa i përket Kërkesave te Përshtatshmërisë Profesionale ka qenë Kërkesa 1. Certifikata e Regjistrimit te Biznesit (ARBK)Dëshmia e kërkuar: Evidenca 1 Certifikata e Regjistrimit të Biznesit (ARBK) -kopje,*Ekspertja shqyrtuese ka verifikuar dokumentet e kërkuar te Operatorit EkonomikVeterina Drenas dhe ne ofertën e tij tek pika 2 dhe 2.1 ka bashkangjitura kopjen qe certifikatës se biznesit duke përfshirë edhe faqen e pare te informatave te biznesit dhe dokumentet e dorëzuar janë si më poshtë :Ekspertja ka verifikuar dokumentin e kontestuar nga OE-ik ankues dhe për këtë pretendim te pikës 1.1 konstaton se është i pa bazuar dhe se Certifikatat e biznesit te Operatoreve Ekonomik janë dorëzuar konform kërkesave te Autoriteti Kontraktues ,me lartë janë dhënë argumentet vetëm për faqen e parë për te cilën OE-ik ankues ka pasur pretendim ndërsa Grupi i EO-ik kanë dorëzuar komplet kopjet e certifikatave te biznesit.

**Konstatimi i dytë (II)** -Sa i përket pretendimit tjetër ankimor te Operatorit Ekonomik ankues te Pretendimit te I te pikës 1.2. *Kërkesat për mundësin teknike dhe profesionale,* Operatori Ekonomik ankues këtë pretendim e ka ndërlidhur edhe me Pretendimin e 4 konkretisht me piken 4.1.- OE Kuqi Farms nuk ka paraqitur dëshmitë e diplomave dhe CV-te e teknikeve te veterinarisë. Konkretisht me kërkesën e Autoriteti kontraktues e cila ka qene: *Kërkesa 1 OE-ik duhet te ofroj dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon- Një veterinar te diplomuar min. 2 vite përvoje pune pas diplomimit ne fushën e trajtimit te kafshëve dhe - Dy teknike te veterinarisë min. 2 vite përvoje pune pas diplomimitDëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmia 1 Si dëshmi duhet dorëzuar kontratën për marrëdhënie pune, kopjet e diplomave dhe CV e tyre me mse paku 2 vite përvoje pune.* Ekspertja shqyrtuese ne baze te dokumenteve te dorëzuara ne ofertën e tije ne fajllin 5.2 konstaton se OE-ik GOE KUQI FARMS SH.P.K. dhe AMBULANCA VETERINERE DRENAS ka prezantuar me kontrata si teknike z.Daut Millaku dhe Kresnik Zogaj per te cilët ka dorëzuar këto dy dokumente: Duke u bazuar ne kontratat e dorëzuar dhe ne Diplomën e z. DAUT Millaku dhe ne certifikatën e notave te z.Kresnik Zogaj sqaron se ne komfort Nenit 38 për Sqarimi i Tenderëve te RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK ne te cilin konkretisht pika 38.3 potencon se: Megjithatë, lejohet që një autoritet

kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyre objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë, është dashur të kërkoje informata sqaruese bazuar edhe në pretendimin e OE-ik ankues se mungojnë CV atëherë komfort udhëzuesit Administrativ nën 72 dhe nën 59 të LPP-së ku thuhet :*CV-ja e kërkuar nuk është dorëzuar - Mund të kërkojen informata sqaruese.*- Autoriteti Kontraktues është dashur të kërkojë informata sqaruese andaj ky pretendim është i bazuar.

Sa i përket Diploma e Veterinarit të prezantuar z. Shkelqim Obrija OE-ik ka dorëzuar dokumentacion komfort kërkesave të Autoriteti kontraktues duke prezantuar kontratën, diplomën dhe CV. Sa i përket pretendimit tjetër ankimor të Operatorit Ekonomik ankues të Pretendimit të I ,te pikës 1.2. Kërkesat për mundësinë teknike dhe profesionale, se Në dosjen e tenderit mungojnë dëshmitë (fatura) për mjetet e punës: kafaz transportues, mjete kimike, qantë ushqimi, rrypa. ? Mungojnë mjete kimike profesionale për trajtimin e kafshëve agresive. Operatori Ekonomik ankues këtë pretendim e ka ndërlidhur edhe me Pretendimin e 4 konkretisht me pikën 4.2. Mungesa e Dëshmive për Mjetet e Punës, ekspertja shqyrtuese sqaron se kërkesa e Autoriteti kontraktues ka qenë: Kërkesa 3 Lista e mjeteve të punës në dispozicion për realizimin e punimeve 1. Pikap Minimum 1 copë 2. Kafaz transportues Minimum 1 copë 3. Qafore, qante ushqimi dhe mjete kimike që mund të përdoren për kafshë agresive Minimum nga një 1 copë. *Dëshmia e kërkuar : Dëshmia 3 Lista e mjeteve duhet të dorëzohet e skanuar nga origjinali - e nënshkruar dhe vulosur nga O.E. Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmojnë me librezën e regjistrimit, ndërsa pajisjet tjera, OE duhet të dëshmojë me një dokument për pronësinë e tyre (faturë, DUD etj). Vëmendje! Në rast se OE nuk posedon ndonjë nga pajisjet e kërkuara, duhet të ofrojë marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. pajisjet motorike të janë të regjistruara dhe kanë sigurim valid. Vërejtje Autoriteti Kontraktues mban të drejtën që të bëjë verifikimin e pajisjeve të ofruara. Në rast të mospërputhjes së të dhënave, OE do të eliminohet.*"Duke u bazuar në dokumentet e dorëzuar në ofertën e Operatorit Ekonomik të propozuar për dhënë të kontratës pikërisht në ofertën e tij pika 7 Lista e pajisjeve ekspertja shqyrtuese sqaron se pavarisht që OE-ik ka prezantuar disa fotografi lidhur me pronësinë e tij për Kafazet transportues , mjetet kimike , qante ushqimi , rrypa sipas kërkesave të Autoriteti kontraktues nuk ka ofruar dëshmi në baze të kërkesave të Autoriteti Kontraktues as në Raportin e Vlerësimit nuk është potencuar se është bërë ndonjë verifikim në teren lidhur me këtë ekspertja shqyrtuese konstaton se ky pretendim është i bazuar.

**Konstatimi i tretë (III)** "- Sa i përket pretendimit tjetër ankimor të Operatorit Ekonomik ankues të Pretendimit të I te pikës 1.3. Verifikimi i objektit të Strehimores , Operatori Ekonomik ankues këtë pretendim e ka ndërlidhur edhe me Pretendimin e 4 konkretisht me pikën 4.3. Verifikimi i Objektit të Strehimores. Ekspertja Shqyrtuese sqaron se kërkesa e Autoriteti Kontraktues sipas Dosjes së tenderit dhe formularit për korrigjim të proceduarës të publikuar me datën 17.05.24 ka qenë : *Kërkesa 4 OE duhet të prezantoj Objektin (tipin) e strehimores se qeneve dhe ambulanten e specializuar për këto shërbime të jete brenda territorit të Komunës së Pejës minimum 15 km. Dëshmia e kërkuar : Dëshmia 4 O.E duhet të duhet të ketë në pronësi të veten Objektin (tipin) e strehimores se qeneve dhe ambulanten brenda territorit të Pejës minimum 15 km të dëshmuar me foto ose fleta poseduese , Në rast se OE nuk posedon Objektin (tipin) e strehimores se qeneve e kërkuara, duhet të ofrojë marrëveshjen për marrjen me qira të Objektit. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet të jetë e noterizuar – e nënshkruar ndërmjet*

*qiradhënësit dhe qiramarrësit në prezencë të noterit.* OE-ik ka dorëzuar dy marrëveshje lidhur me dy Objekte te ndryshme si më poshtë: Duke u bazuar ne marrëveshjen e dorëzuar e cila është noterizuar mirëpo bashkangjitur ne këtë marrëveshje janë fotografit me larte te cilat nuk dëshmon se objekti i strehimores mund te jete ekzistues, duke konsideruar këtë ekspertja shqyrtuese ne pa mundësi për te vizituar këtë lokacion për te verifikuar nga afër objektin se a është ekzistuese , ekspertja për mes formës se Geo portalit dhe maps konstaton se ky objekt nuk ekziston ne baze te atë qe ka siguruar si me poshtë :Andaj lidhur me këtë pretendim ekspertja konstaton se është i bazuar dhe se mbetet verifikimi i objektit ne këtë nr. kadastral 00559-5 nga Autoriteti Kontraktues lidhur me këtë pretendim."

***Konstatimi i katërt (IV)*** "-Sa i përket pretendimit tjetër ankimor te Operatorit Ekonomik ankues te Pretendimit te I te pikës 1.4.Mungesa e Dokumentacionit për Grupin e Operatorëve Ekonomik , ankuesi këtë pretendim e ka ndërlidhur edhe mePretendimin e 3 konkretisht me piken 3.1. Mungesa e Objektivitetit ne Vlerësimin e Ofertave.Duke u bazuar ne këtë pretendim ekspertja shqyrtuese sqaron se ne baze se RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK –Neni 26 Grup i Operatorëve Ekonomik grupi i OE-ik duhet te dorëzoj : Dorëzon një deklaratë të qartë që të gjithë anëtarët e grupit janë së bashku dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e tenderit të grupit, dhe në rast se grupit i jepet kontrata, për performancën e kontratës;b. Dorëzon një deklaratë të nënshkruar nga secili nga anëtarët, që konfirmon pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se nuk janë duke marrë pjesë individualisht dhe/ose në grupe tjera në procedurën e njëjtë të prokurimit (deklarata elektronike mund të nënshkruhet duke përdorurnënshkrimin elektronik të avancuar nëse është i aplikueshëm);c. Një deklaratë e nënshkruar nga të gjithë anëtarët të grupit për të autorizuar partnerinudhëheqës të veproj në emër të grupit (deklarata elektronike mund të nënshkruhet duke përdorur nënshkrimin elektronik të avancuar nëse është i aplikueshëm; dhe d. Secili anëtar i grupit duhet të jëtë i regjistruar në platformën elektronike, kërkesë e ciladuhet të përcaktohet në dosje të tenderit.(Nënshkrimi digjital i avancuar nuk është i obligueshëm deri në njoftim zyrtar nga KRPP); 26.2 Deklaratat e kërkuara në (a), (b) dhe (c) të paragrafit 26.1, mund të përfshihen në një dokument.Ekspertja shqyrtuese konstaton se marrëveshjes se konsorciumit ndoshta i mungon përpilimi me i modifikuar ,ndërsa s ai përket marrëveshjes se koncerciumt për ekspertin është pranueshme pasi qe ne baze te pikave te potencuar me larte a,b,c dhe d Operatori i propozuar për dhenje te kontratës ka dorëzuar deklarata ne baze pikave me larte mirëpo ndoshta modifikimi do te mund te ishte me i qarte por gjithsesi si marrëveshje e koncerciumit ekspertja shqyrtuese konstaton se është i pranueshëm dhe se ky pretendim është i pa bazuar."

***Konstatimi i pestë (V)*** "-Lidhur me pretendimin e 2 te konstatuar nga OE-IK LIDHUR ME NENIN7 Barazia ne trajtim / Jo diskriminim ). Ekspertja shqyrtuese duke analizuar rreth përmbajtje këtij pretendimi si dhe letrës standarde për arsyen e eliminimit konstaton se ky pretendim është i bazuar pasi arsyetimi i AK-se është siç vijon: Letër standarde për [tenderuesin] [kandidatin] e eliminuar 1-19.06.2024, Pejë A.K. KOMUNA E PEJËS O.E : Grup i Operatorëve Ekonomik N.T.SH. VETERINA - PEJË; Haki Bytyçi B.I. Nr. i prokurimit:635-24-4874-2-1-1 Nr i brendshëm 635-24-073-211 Titulli: Trajtimi i qeneve endacak dhe menaxhimi i strehimores ne Komunën e Pejës RITENDER I/e nderuar(a) Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim “LPP ”. [Tenderi juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në [dosjen e tenderit] [dokumentet para kualifikuese]. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:[shënoni katrorin gjegjës]: [Tenderi i juaj]

[Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është administrativisht e papërgjegjshme: Nuk i keni përmbushur kërkesat e sigurisë së tenderit; Nuk i keni plotësuar dhe nënshkruar si duhet [Formularin e paraqitjes së tenderit] [Formularin e paraqitjes së aplikacionit]; Nuk i keni përmbushur kërkesat e vlefshmërisë së tenderit; Nuk e keni paraqitur numrin e mjaftueshëm të kopjeve të kërkuara; Nuk e keni paraqitur deklaratën e cila identifikon nënkontraktuesit e zgjedhur për aktivitetin relevant të prokurimit; Gabimi(et) aritmetikor i evidentuar(a) është më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës; Oferta e juaj, në përputhje me nenin 61.4 është konsideruar si oferte abnormalisht e ulët. Nëse është e zbatueshme, kërkesa tjera formale/administrative. [Në rast të Grupit të Operatorëve Ekonomik]?? Nuk keni paraqitur një deklaratë të qartë se të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e tenderit të grupit dhe, në rast se grupit i është dhënë kontrata, performancën e kontratës;?? Nuk keni paraqitur deklaratën e nënshkruar nga secili anëtar, e cila konfirmon pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë në mënyrë individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër pjesëmarrës në procedurën e njëjtë të prokurimit;?? Nuk keni paraqitur deklaratën e nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit e cila autorizon partnerin udhëheqës të veprave në emër të grupit; Partneri juaj nuk i ka përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë.1 Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëturshme ngase kanë qenë të pa përgjegjshëm dhe të parregullt. [Në rast të nënkontraktimit] Nën-kontraktuesi (t) juaj nuk i ka përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë. [Tenderi i juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është i papërgjegjshëm sepse nuk keni dorëzuar: Certifikatat apo dëshmitë e kërkuara të cilat tregojnë apo pohojnë se nuk jeni i diskualifikuar nga ndonjë masë nën Nenin 65 të LPP; Certifikatën, dokumentin ose ndonjë dëshmi tjetër të mjaftueshme të kërkuar sipas Nenit 66 të LPP për të dëshmuar përshtatshmërinë profesionale tuaj; Dëshmi të mjaftueshme, siç është përshkruar në nenet 68 dhe 69 të LPP, që tregojnë arsyeshëm se i përmbushni kërkesat minimale të gjendjes ekonomike dhe financiare dhe të kapacitetit teknik/profesional të saktësuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. ARSYETIM [Ju jeni diskualifikuar ] [Tenderi juaj është refuzuar] për këto arsye :O.E: Grup i Operatorëve Ekonomik N.T.SH. VETERINA - PEJË; Haki Bytyçi B.I. Ju njoftojmë se komisioni vlerësues duke u mbështetur në vendimin e AK të datës 12.04.2024 ku ju njoftojnë që jeni si OE i pa përgjegjshëm ku ne si AK jemi duke e respektuar Nenin 25.9 të Rregullores dhe Nenin 99.2 të LPP-se. Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Edhe nëse nuk kemi qenë në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit. Autoriteti kontraktues është bazuar në nenin 25.9 i cili thotë : 25.9 Vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë (përveç Deklaratës nën Betim) do të kërkohen të dorëzohen nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shpërblejë me kontratë. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para publikimit të Njoftimit B58 mbi vendimin e AK-së. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është jo më shumë se pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të autoritetit kontraktues për synimin e dhënies së kontratës. Dështimi në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar në vendin e dytë, si dhe do të konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar dhe AK do të iniciojë procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se. Autoriteti Kontraktues ka iniciuar për ne listën e zeze me datën 12.04.2024 në organin Shqyrtues të Prokurimit, po ekspertja shqyrtuese konstaton se sipas përderisa Autoriteti Kontraktues nuk është informuar me shkrim lidhur me ndonjë vendim vendimmarrës rreth kësaj kërkeje Autoriteti

kontraktues është dashur të zbatohet nën 7 të LPP-se. Ku edhe sipas Neni 133 - Deklaratat e jo-efektiviteti thuhet se : *Ofertuesit do të konsiderohen të jenë një palë me interes, nëse ato nuk janë përjashtuar definitivisht ende nga një tender dhe se një përjashtimi është definitiv nëse ajo ka qenë e njoftuar për këtë tender dhe ka qenë konsideruar i ligjshëm ose nga një organ i pavarur ose nuk mund të nënshtrohet një procedure shqyrtimi.*

**Konstatimi i gjashtë** "- Lidhur me Pretendimin 5 :Ekspertja sqaron se këtë pretendim nuk mund të argumentoj pasi që nuk është kompetencë e ekspertës të argumentojrreth procedurës të një diskualifikimi të me hereshëm lidhur me iniciativën e Operatorit Ankues pran Organit Shqyrtues të Prokurimit.E vetmja që ekspertja mund të konstatojë në këtë pretendim është se OE-ik ankues N.T.SH. VETERINA – PEJË është dashur nga Autoriteti kontraktues të konsiderohet si palë e interesit deri sa të ketë një vendim përfundimtar nga Organi Shqyrtues i prokurimit.

Paneli Shqyrtues sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues N.T.SH. “VETERINA” - PEJË Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertës mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertës. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues N.T.SH. “VETERINA” - PEJË janë të bazuara.

#### **- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –**

Paneli shqyrtues ka për detyrë të vlerësojë Raportin e ekspertit shqyrtues, të cilin e ka kërkuar në lidhje me kontestin e ngritur në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik. Ky raport, i përgatitur nga eksperti, duhet të përmbajë të gjitha elementet e nevojshme që parashikohen nga dispozitat ligjore të nenit 113 dhe nenit 114 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP). Sipas këtyre neneve, eksperti është i detyruar të shqyrtojë të gjithë dokumentacionin e prokurimit, të përfshijë të gjitha pretendimet ankimore dhe të ofrojë një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve të paraqitura në ankesa.

Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se raporti i ekspertizës nuk është obligativ për Panelin shqyrtues. Ky raport duhet të vlerësohet dhe/ose të analizohet në kontekstin e të gjitha dokumenteve të tjera të lëndës, përfshirë faktet e paraqitura dhe provat eventuale të tjera që mund të ndikojnë në rastin në shqyrtim. Paneli duhet të marrë parasysh natyrën e shkeljeve të mundshme, rrjedhën e aktivitetit të prokurimit, dhe qëllimin e tij në përputhje me ligjin e aplikueshëm.

Në përfundim, Paneli shqyrtues ka autoritetin dhe përgjegjësinë për të vendosur nëse do ta mbështesë raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë rekomandim të dhënë nga ky raport. Ky gjykim duhet të bazohet në një analizë të pavarur dhe profesionale, siç parashikohet në nenet 98 dhe 99 të Ligjit të Prokurimit Publik, në lidhje me nenin 105 të këtij ligji. Kjo do të thotë që Paneli, në përputhje me detyrimet e tij ligjore, duhet të përdorë këto burime në mënyrë të arsyeshme dhe të drejtë, duke bërë një shqyrtim të plotë dhe të thellë të të gjitha faktoreve të rëndësishëm të rastit.

Paneli Shqyrtues, pas një analize të thelluar të të gjitha shkresave të lëndës, veprimeve të ndërmarra nga palët e përfshira, deklaratave të tyre dhe provave të administruara gjatë procesit të prokurimit, ka arritur në përfundimin se gjetjet dhe vlerësimet e raportit të ekspertit shqyrtues

janë të pranueshme. Paneli ka vlerësuar që raporti i ekspertit është marrë në konsideratë në mënyrë të drejtë gjatë vendimmarrjes. Si pasojë e kësaj analize, Paneli Shqyrtues i ka dhënë besim të plotë raportit të ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankues dhe, duke e konsideruar ankesën si të bazuar, ka vendosur të anulojë njoftimin për dhënie të kontratës dhe të kthejë aktivitetin e prokurimit në fazën e rivlerësimit.

Paneli Shqyrtues ka realizuar një shqyrtim të pavarur, të objektivizuar dhe me kujdes profesional të të gjitha provave që kanë qenë të disponueshme në këtë rast. Gjatë këtij procesi, është konstatuar se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore që rregullojnë prokurimin publik dhe me kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e specifikuar "Trajtimi i qenve endacak dhe menaxhimi i strehimores në Komunën e Pejës RITENDER" me numër të prokurimit: 635-24-4874-2-1-1. Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se ekspertja shqyrtuese ka trajtuar pretendimet e operatorit ekonomik ankues N.T.SH. "VETERINA" - PEJË në një mënyrë profesionale dhe objektive, dhe se argumentimi në raportin e ekspertit është i detajuar, i kuptueshëm dhe i mbështetur plotësisht në dokumentet relevante që lidhen me aktivitetin e prokurimit.

Konstatimet e raportit të ekspertit janë të verifikueshme përmes dosjes së tenderit dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Si pasojë e kësaj, Paneli Shqyrtues ka konfirmuar se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të bazuara dhe ka vendosur të pranojë në tërësi raportin e ekspertit, duke e konsideruar të justifikuar dhe të bazuar në dokumentacionin e administruar.

Paneli Shqyrtues, duke shqyrtuar në detaje përshkrimin dhe faktet e përmendura më lart, ka analizuar ankesën e operatorit ekonomik ankues, duke e pasur parasysh dokumentacionin e lëndës dhe argumentet e paraqitura. Në përfundim të kësaj analize, Paneli ka vlerësuar se ankesa e operatorit ekonomik është e bazuar dhe e arsyeshme. Në këtë kontekst, Paneli rekomandon që aktiviteti i prokurimit për "Trajtimi i qenve endacak dhe menaxhimi i strehimores në Komunën e Pejës RITENDER", me numrin e prokurimit 635-24-4874-2-1-1, të kthehet në fazën e rivlerësimit. Paneli gjithashtu rekomandon që Autoriteti Kontraktues (AK) të veprojë në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP).

Në përputhje me këtë rekomandim, Paneli Shqyrtues ka vendosur të anulojë njoftimin për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e përmendur dhe të rikthejë lëndën në fazën e rivlerësimit. Kjo vendimmarrje është bazuar në një shqyrtim të thellë dhe të arsyeshëm të të gjitha dokumenteve dhe provave të administruara gjatë procedurës së prokurimit.

Paneli Shqyrtues ka arritur në këtë vendim pas një shqyrtimi të hollësishëm të veprimeve dhe aktit të Autoritetit Kontraktues, si dhe vlerësimeve të ekspertit shqyrtues në lidhje me përmbushjen e kushteve të specifikuara në dokumentacionin e tenderit. Konstatimet e raportuara dhe pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë konsideruar të mjaftueshme për të justifikuar rikthimin e aktivitetit të prokurimit në fazën e rivlerësimit.

Paneli Shqyrtues, në përputhje me kompetencat e tij ligjore të përcaktuara në nenin 104, paragrafi 1, në lidhje me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të Ligjit të Prokurimit Publik, ka vepruar për të siguruar që procedura e shqyrtimit të prokurimit të realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim. Kjo është bërë me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Paneli ka bazuar konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashikojnë dhe rregullojnë situata të tilla që mund të ndodhin gjatë një aktiviteti të prokurimit, duke siguruar që çdo vendim të jetë në përputhje me ligjin dhe standardet e kërkuara.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Kimete Gashi**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E PEJES**
- **OE - N.T.SH. VETERINA - PEJË**
- Arkivës së OSHP-së: